

Kur foshnja im thith qumështin, ai i kalon përmes hundës

Jam mama e një vajze të vogël të quajtur Lili. Që prej lindjes së saj, ndjej që diçka nuk shkon. Nuk është si për vëllain e saj që tani është 5 vjeç. Nuk kam arritur ta ushqej me gji Lilin, madje dhe ushqyerja me biberon është e vështirë. Mbi të gjitha, i del gjithmonë qumësht nga hunda madje edhe mbetje kompostosh që kur kam filluar t'i jap ushqime të ndryshme. Mjekja pediatre dhe PMI [NdT/ Mbrojtje e nënës dhe fëmijës] më thonë që unë shqetësohem shumë, që Lili po zhvillohet mirë dhe që ajo ka thjesht pak kthim ushqimi nga stomaku.

A është normale që ushqimet të kalojnë përmes hundës? A bëhet fjalë për kthim ushqimi apo refluks në këtë rast?

Termat refluks dhe regurgitim (kthim i ushqimit nga stomaku në gojë) shpesh ngatërrohen me fenomenin e përshkruar nga nëna e Lilit. Dhe kjo nënë ka të drejtë që këmbëngul se kjo nuk është normale.

Regurgitimet

janë fenomene klasike tek një foshnjë. Nuk janë vjellje por ngjitje të qumështit. Këto nxjerrje bëhen përmes gojës, gjë që i dallon mirë nga ajo që përshkruan nëna e Lilit. Disa bebe mund të kenë regurgitime shumë të shpeshta dhe të dhimbshme që mund sjellin vështirësi në të ushqyer dhe të bëjnë të nevojshëm një trajtim. Por këtu bëhet fjalë për kalime të ushqimeve të lëngshme, gjysmë të lëngshme, apo edhe të ngurta përmes hundës.

C ‘farë funksionon keq tek Lili? A ka rrezik për të?’

Nëse ushqimi kalon përmes hundës, kjo ndodh sepse ajo nuk është mbyllur mirë nga goja kur Lili është duke u ushqyer. Velloja e qiellzës nuk funksionon normalisht dhe kjo shpjegon padyshim edhe përse ushqyerja me gji nuk mundi të vazhdonte dhe që ushqimi me biberon të jenë të vështirë.

Normalisht, për të thithur, duhet të mund të bëhet zbrazja e gojës dhe të evitohet që ajri të dalë nga hunda. E njëjta gjë, kur ushqimi është në gojë, supozohet që ai të zhvendoset drejt ezofagut, dhe më pas në stomak.


Nëse valvula (velloja e qiellzës) mbyllet keq, ushqimi mund të shkojë në hundë. Kështu ndodh me Lilin. Kjo nuk është e rrezikshme, por është shumë e pakëndshme dhe mund të irritojë pjesën e brendshme të hundës (zgavrat e hundës). Nga

ana tjetër, Lilit nuk i shkon keq ushqimi. Shkuarja keq do të thotë se ushqimet kanë marrë rrugë të gabuar. Ato shkojnë në trake dhe për rrjedhojë në mushkëri. Në këtë rast, ajo që nuk funksionon gjendet përtej vellos së qiellzës dhe kjo mund të jetë shumë serioze. Nëse një foshnjë kollitet vazhdimisht kur pi ose kur ha, duhet të takoni pediatrin sa më shpejt të jetë e mundur. Edhe njëherë, ky nuk është rasti i Lilit.

Pse velloja e qiellzës së Lilit nuk e mbyll kalimin për në hundë?

Ajo që do të mundësojë izolimin e hundës nga goja është ajo që quhet vello e qiellzës. Tërësia e këtyre pesë muskujve gjendet në zgjatim të qiellzës së fortë. Ajo mund të tkurret dhe të mbyllë rrugën drejt hundës sepse muskujt e saj janë shumë të përkulshëm dhe lëvizin lehtësisht. Ata duhet të vihen në kontakt me murin e faringut

(pjesën e pasme të fytyrës) për të izoluar hundën nga goja. Velloja shërben për shumë gjëra. Për shembull, parandalon kalimin e ushqimit në hundë gjatë ngrënies, por gjithashtu lejon krijimin e një boshllëku për thithje, gjë që shpjegon vështirësitë e thithjes së Lilit.



Funksionimi Hundor

Mungesa ose mbyllja keq e vellos quhet inkompetencë (paaftësi) ose insuficiencë (pamjaftueshmëri) vellofaringeale. Ka dy mundësi që mund të shpjegojnë këtë fenomen dhe kjo duhet të rezultojë nga një konsultë me një kirurg specialist.

- ose velloja e qiellzës është krejtësisht e shëndetshme por tkurret keq pa ndonjë arsye të veçantë. Në këtë rast, një ekzaminim i thelluar i shoqëruar me një intervistë të hollësishme apo edhe me një konsultë gjenetike dhe evolucioni i fëmijës, do të mundësojnë përcaktimin e një diagnoze të saktë.
- ose velloja e qiellzës ka një shenjë që paralajmëron në lidhje me strukturën e saj. Njerithi ("kambana" e vogël që shihet kur thuhet "A" me zë të lartë ose kur foshnja qan) mund të ketë një prerje të vogël ose të jetë pjesërisht e çarë. Më e ndërlikuar për t'u nxjerrë në pah, pjesa e jashtme e vellos është e

padëmtuar, por tkurrja e saj tregon se nën mukozën, muskujt nuk janë të pozicionuar mirë. Është një çarje nën-mukoze dhe ndonjëherë shtrihet edhe në qiellzën e fortë.

Fëmijës nuk i mungon asgjë, të gjitha strukturat anatomike janë aty, por nga ana tjetër ato mund të jenë pozicionuar keq. Është kompleksiteti i përcaktimit të një diagnoze të tillë që kërkon konsultën e specializuar.

Ndërkohë, mund t'i rekomandohet nënës së Lilit që të sigurohet që fëmija i saj të jetë i pozicionuar mirë për të ngrënë. Është thelbësore që ai të ushqehet vertikalisht: ulur dhe jo shtrirë.

Çfarë mund të bëhet për Lilin nëse ka një çarje nën-mukoze?

Është evolucioni i Lilit dhe sa të rënda janë pasojat në zhvillimin e saj që do ta orientojnë kirurgun drejt një operacioni.

Në përgjithësi, fëmijët e menaxhojnë ushqimin gjithnjë e më mirë. Por velloja e qiellzës shërben edhe për të folur dhe me kalimin e kohës, nëse funksionon keq, kjo mund ta bëjë shumë të vështirë përvetësimin e disa tingujve ose edhe të sjellë një zë me timbër hundor: fëmija flet me hundë.

Velloja e qiellzës shërben edhe për ajrimin e veshit. Është fenomeni që ndjejmë kur na hapet goja, marrim avionin ose zhytemi nën ujë. Nëse velloja funksionon jo aq mirë, veshi do të jetë më pak i ajrosur dhe lëngu mund të grumbullohet pas daulles së veshit të Lilit. Ajo rrezikon të ketë infeksione sero-mukoze të veshit të cilat janë shumë të

vështira për t'u dalluar. Gjatë kësaj kohe, Lili do të dëgjoj dobët dhe nuk do ta zhvillojë normalisht të folurin e saj.

Prandaj është e domosdoshme të kryhen teste të rregullta ORL në rast insuficiencë velare, përveç një kontrolli vjetor në një qendër të specializuar për çarjet.

E nëse kjo vazhdon dhe pengon zhvillimin e Lilit? Çfarë mund të bëhet ?

Nëse ka çrregullime të dëgjimit të identifikuar, atëherë do të jetë e mundur vendosja e aeratorëve/yoyos/T-Tubes në veshë. Nëse ka një ndikim të lehtë në zhvillimin e fjalës dhe të folurit, atëherë Lili do të duhet të vizitohet nga një specialist i të folurit.

Në rast çrregullimesh më të rënda, Lili do të operohet. Kirurgu do të kryejë një operacion për të rivendosur muskujt në një pozicion të mirë dhe të mundësojë kështu që qiellza e butë të mbyllet hermetikisht kur është e nevojshme. Kjo do të përmirësojë artikulimin, dëgjimin dhe ndoshta do të eliminojë disa kalime të lëngjeve që mund të zgjasin.

<https://www.tete-cou.fr/offre-de-soins/reseau-maface>

Nëse fëmija juaj shfaq shenja të kalimit të ushqimit përmes hundës, është e domosdoshme të konsultoheni me një nga 24 qendrat e specializuara me etiketën Maface, detajet e kontaktit të së cilës gjenden në faqen e internetit të sektorit të sëmundjeve të rralla: tete-cou.fr

Kirurgët dhe logopedistët e këtyre qendrave do të mund të nxjerrin në pah shenjat klinike të insuficiencës (pamjaftueshmërisë) velofaringeale. Kështu, nëse operacioni rezulton i nevojshëm, do të jeni të sigurt në një qendër dhe nuk do të

humbni kohë në kërkim të një diagnoze dhe më pas të një kirurgu. Diagnoza e hershme është një garanci për një trajtim më të mirë dhe ndjekje afatgjatë për fëmijën tuaj.